



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Doretuar Prilmen/Prodato Received/Delivery	01.09.2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ/Jedinica Org/Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	5064/2022		1/5



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.659/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.659/2022 të datës 26.07.2022 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit me Nr.02-112/02-0060475/22 të datës 22.07.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevës, në çështjen juridike "Transferim i Përkohshëm", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 01.09.2022, mori këtë

### V E N D I M

I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.659/2022 e datës 26.07.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. **SHFUQIZOHET** Vendimi me Nr.02-112/02-0060475/22 i datës 22.07.2022 i Kryetarit të Komunës së Podujevës.

III. **OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Podujevës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin në pozitën "Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit" sipas Akt Emërimit të datës 03.01.2020 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## Arsyetim

Ankuesi i punësuar në Komunën e Podujevës përmes emailit [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net), më datë 26.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 4307/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.02-112/02-0060475/22 të datës 22.07.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevës për transferim të përkohshëm, me pretendimet se vendimi është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.08.2022 ka dërguar kërkesën e ankuesit për përgjigje në ankesë në Komunën e Podujevës. Ndërsa Këshilli, më datë 08.08.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 26.07.2022 me numër protokoli 4307/2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga E.A. për [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net) 26.07.2022; Vendimin për transferim të përkohshëm me Nr.02-112/02-0060475/22 të datës 22.07.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevës; Akt Emërim i E.A. i datës 03.01.2020; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 01.08.2022; Përgjigje në ankesë e datës 08.08.2022; Përshkrimi i Detyrave të Punës; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 20.07.2022; Kërkesë për transfer i datës 20.07.2022; Pëlqim për transfer i datës 21.07.2022; E-mail nga E.A. për E.C. i datës 26.07.2022; E-mail nga E.C. për E.A. i datës 22.07.2022; Pliki me nr. R2168585 i datës 04.08.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit, është e bazuar sepse:

Nga administrimi i provave materiale të kësaj çështje juridike, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 03.01.2020 është i punësuar në pozitën "Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit" në Komunën e Podujevës. Më tutje pas kërkesës për transfer të datës 20.07.2022 të Drejtorit të Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit për Drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit, me të cilën është kërkuar që të propozoni një zyrtar për transferim, ku ky i fundit më datë 21.07.2022 ka dhënë pëlqimin për transferim ku ka propozuar që ankuesi është i përshtatshëm për kryerjen e detyrave në drejtorin përkatëse.

Kryetari i Komunës së Podujevës më datë 22.07.2022 ka nxjerr Vendim me Nr.02-112/02-0060475/22 me të cilin ka bërë transferimin e përkohshëm të ankuesit nga pozita Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit në pozitën Zyrtar për Mbrojtje të Mjedisit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.02-112/02-0060475/22 të datës 22.07.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevës për transferim të përkohshëm, pretendon që ky transferim është bërë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi konkretisht nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr. (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil sepse e ka nxjerr personi jo kompetent, është nxjerr në kundërshtim me nenin 52 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores Nr. (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, sepse nuk është përcaktuar kohëzgjatja e transferimit, Vendimi nuk përmban elementet e aktit administrativ sipas nenit 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që Vendimi me Nr.02-112/02-0060475/22 i datës 22.07.2022 i Kryetarit të Komunës së Podujevës për transferim të përkohshëm është nxjerr në kundërshtim me legjislacionin në fuqi konkretisht nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr. (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil sepse e ka nxjerr personi jo kompetent, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka analizuar dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë transferimin e nëpunësve civil gjegjësisht sipas nenit 5 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë është përcaktuar se: *"Transferimi i përkohshëm në interes të institucioni, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësisht nga ana e nëpunësit të kritereve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet"*, në këtë kontekst e në mbështetje të nenit 14 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë njësia përgjegjëse konsiderohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, andaj edhe vendimi është nxjerr nga personi jo kompetent dhe si i tillë është i kundërligjshëm, kështu që pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke e shqyrtuar pretendimin e ankuesit i cili pretendon se Vendimi me Nr.02-112/02-0060475/22 i datës 22.07.2022 i Kryetarit të Komunës së Podujevës për transferim të përkohshëm, është nxjerr në kundërshtim me nenin 52 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores Nr. (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, sepse nuk është përcaktuar kohëzgjatja e transferimit, ka konstatuar që dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht neni 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, ka përcaktuar që: *"Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve"*, mirëpo në Vendimin me Nr.02-112/02-0060475/22 të datës 22.07.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevës për transferim të përkohshëm përveç që në preambulë është përshkruar neni 52 paragrafi 1.1 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nuk është saktësuar kohëzgjatja e transferimit, e që në bazë të këtij neni është obligim të përcaktohet saktë kohëzgjatja e transferimit, kjo parashihet edhe me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në këtë kuptim pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit i cili pretendon se Vendimi me Nr.02-112/02-0060475/22 i datës 22.07.2022 i Kryetarit të Komunës së Podujevës për transferim të përkohshëm nuk përmban elementet e aktit administrativ sipas nenit 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se vendimi i atakuar me ankesë nuk përmban të gjitha elementet e aktit administrative konkretisht nuk përmban saktë pjesën urdhëruese (dispozitivin), nuk përmban pjesën arsyetuese dhe nuk përmban këshillën juridike, siç parashihet me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.4 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Akti administrativ i shkruar përmban: 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjete juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë”*. kështu që pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Andaj, bazuar si më lartë, e në vështrim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një akt administrativ i nxjerrë nga organi që nuk ka kompetencë, me shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale është akt administrativ i paligjshëm, kështu që Këshilli me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, e duke iu bazuar në autorizimet e përcaktuara me nenin 55 paragrafët 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka shfuqizuar Vendimin me Nr.02-112/02-0060475/22 të datës 22.07.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevës, duke obliguar këtë të fundit që brenda afatit të përcaktuar si në pikën III të dispozitivit ta kthejë ankuesin në pozitën “Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit” sipas Akt Emërimit të datës 03.01.2020 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda : A.nr.659/2022**

**Çlirim ZEKA**

*Çlirim ZeKa*  
Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Podujevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

